## SYLLABUSI I LËNDËS "GJUHË ANGLEZE III PËR SHKENCA KOMPJUTERIKE"

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i Shkencave Kompjuterike |
| **Titulli i lëndës:** | Gjuhë Angleze III për Shkenca Kompjuterike |
| **Programi:** | Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi |
| **Niveli:** | Baçelor |
| **Statusi lëndës:** | Zgjedhore |
| **Viti i studimeve:** | 2 |
| **Numri i orëve në javë:** | 2+2 (ligjërata dhe ushtrime) |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 6 ECTS |
| **Koha / lokacioni:** | Të publikuara në web site të universitetit! |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | Dr. Skender Shala |
| **Të dhënat kontaktuese:** | shalaskenda@gmail.com |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Lënda ofron informacionin bazë për rëndësinë e gjuhës angleze në ditët e sotme dhe domosdoshmërinë për ta mësuar atë dhe përfitimet që na sjell njohja e saj. Gjuha angleze është bërë gjuha e komunikimit ndërkombëtar, medias dhe internetit, kështu që mësimi i anglishtes është i rëndësishëm për shoqërim, argëtim si dhe për punë. Mësimi i anglishtes është i rëndësishëm pasi ju mundëson të komunikoni lehtësisht me bashkëqytetarët tuaj globalë. Është një gjuhë shumë e dobishme për faktin se duke njohur anglishten, si gjuhë dominuese e biznesit, shkencës, kompjuterëve, diplomacisë dhe turizmit, mund të krijohen shumë mundësi dhe të bëheni konkurrues ndaj fuqisë punëtore globale për çdo lloj pozicioni pune. Nga ana tjetër, të folurit anglisht ndihmon për të krijuar një lidhje të vërtetë me njerëzit dhe për të ditur më shumë rreth kulturave, vendeve dhe stileve të ndryshme të jetesës. Në nivel individual, përmirëson personalitetin dhe rrit ndjenjën e vetëvlerësimit. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Qëllimi i lëndës është i fokusuar në tri drejtime të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Përmirësimin e shkathtësive të leximit dhe fjalorit përmes leximit të teksteve në liber dhe analizimit të fjalëve të reja që janë të panjohura për studentët. Prezantimin e gramatikës bazike të domosdoshme në kontekstin e temave si dhe rishikim të të gjitha njohurive paraprake. Përmes kësaj studentët njohin më mire natyrën e gjuhës që do të ju ndihmojë atyre të kuptojnë dhe përdorin konceptet gramatikore më mire. Zhvillimin e shkathtësive orale përmes komunikimit për tema të ndryshme që janë atraktive për studentët. |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit:** | Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do jetë në gjendje:<br>• Të kuptojnë informacionet bazike të të mësuarit të gjuhës angleze si dhe mundësitë që ofron njohja e saj.<br>• Të kuptojnë gramatikën bazë që është e nevojshme për njohjen e gjuhës angleze dhe të jenë në gjëndje të aplikojnë përdorimin e saj në mënyrën e duhur.<br>• Të komunikojnë rrjedhshëm rreth temave të ndryshme |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | dhe të kenë fjalor më të gjërë të gjuhës angleze. | | |
| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | 1 | 2 | 2 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 5 | 5 |
| Ushtrime në terren | 1 | 1 | 1 |
| Kollokfiume, seminare | 2 | 2 | 4 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 2 | 4 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 10 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 5 | 6 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 3 | 6 |
| Projektet, prezantimet, etj | 4 | 2 | 8 |
| **Totali** | | | **150 orë (6 ECTS)** |
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Lënda është kombinim i ligjëratave, diskutimeve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, ndërsa detyrat prezantohen nga mësimdhënësi në laborator. | | |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | • Vijueshmëria në ligjërata dhe ushtrime: 10%<br>• Projekti: 10%<br>• Kollokviumet: 80%.<br>• Ose provimi përfundimtar: 100%. | | |
| **Literatura** | | | |
| **Literatura primare:** | 1. Michael Harris, David Mower, and Anna Sikorzynska. “OPPORTUNITIES” Intermediate Students’ Book (obligative), Intermediate Language Powerbook (libri i detyrave dhe ushtrimeve)<br>2. Christina Ruse. “New Opportunity” Mini Dictionary – Intermidiate.<br>3. Fjalori: Fjalori Anglisht – Shqip (Autorë të ndryshëm)<br>4. Fjalori: Oxford Advanced Learner’s Dictionary | | |
| **Literatura shtesë:** | 5. BARBARA MACKAY: English for Everyone: Level 3: Intermediate, Practice Book: A Complete Self-Study Program, DK, 2016;<br>6. Olly Richards: Short Stories in English for Intermediate Learners: Read for pleasure at your level, expand your vocabulary and learn English the fun way! (Foreign Language Graded Reader Series) Bilingual Edition, Kindle Edition, 2019;<br>7. Alexander Pavlenko: English, Short Stories, Intermediate Level (English Fluency Practice, Intermediate Level Book 4) Kindle Edition, Sapcrystals plc, 2014. | | |

| Plani i dizajnuar i mësimit: | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| *Java e parë:* | Prezantimi i syllabusit (rreth ligjëratave).<br>Prezantimi i studentëve. | Prezantimi i syllabusit (rreth ushtrimeve).<br>Pritshmëritë nga studentët në fund të semestrit. |
| *Java e dytë:* | Moduli 1: Avantura:<br>Ngrohje, Fjalor (Bashkëvendosja, udhëtimi dhe koha e lirë, formimi i fjalëve, etj.<br>Dëgjim: Monolog, TV program, intervistë, strategjitë e dëgjimit, intervistimi i partnerit, etj.<br>Lëxim: Anglishtja në mileniumin e tretë, Eksploruesit, strategjitë e leximit, Tregimet e udhëtarëve, Sportet Ekstreme, lidhshmëritë, foljet shumë-pjesëshe, etj.<br>Gramatikë: Koha e Tashme e Thjeshtë, Koha e Tashme e Vazhduar, Koha e Kryer, Nyjet, Parafjalët, Mbiemrat e sasisë.<br>Bisedë: Komunikim rreth fotografive, boshllëqet e informacionit, përshkrimi i fotografike, biseda rreth sporteve të ndryshme dhe temave atraktive, bisedë rreth ëndërrave. | Fjalor: Fjalët dhe shprehjet në lidhje me aventurat.<br>Gramatikë: Koha e tashme, Koha e tashme e vazhduar dhe Koha e kryer.<br>Shkrim: Lidhëzat joformale (Actually, luckily); pikësimi; letra joformale<br>Shqiptim: Mbaresa e vetës së tretë njëjës.<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: foljet aktive dhe të gjëndjes. |
| *Java e tretë:* | Moduli 2: Tregimet e jetës:<br>Ngrohje, Fjalor (Tregimet, fjalët kyçe rreth tekstit, modifikuesit, foljet shumë-pjesëshe 2, etj.)<br>Dëgjim: mesazhet e regjistruara telefonike, dialogje rreth filmave, etj.<br>Lëxim: tregim i shkurtër nga H.G. Wells, lëximi i strategjive, boshllëqet e paragrafeve, ekstrakti autobiografik, pyetjet të vërteta/pavërteta, etj.<br>Gramatikë: Koha e tejshkuar<br>Bisedë: përshkrimi i fotove, tregimi i tregimeve, bisedë rreth filmave, bisedë e lire sipas preferencave të studentëve. | Fjalor: Fjalë dhe shprehje në lidhje me llojet e tregimeve.<br>Gramatikë: Koha e tejshkuar: Koha e kryer e thjeshtë vs Koha e shkuar e vazhduar.<br>Shkrim: Fjalët lidhëse kohore (later, then, suddenly); shqiptimi (bashkëtingëllorja e dyfishtë) një tregim avanture.<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: Used to dhe would. |
| *Java e katërt:* | Moduli 3: Udhëtimi:<br>Ngrohje, Fjalor (transporti, fjalët e udhëtimit, problemet e transportit, udhëtimi në ajër, foljet shumë-pjesëshe 3, etj.) | Fjalor: Fjalët dhe shprehjet për transportin.<br>Gramatikë: Koha e kryer e thjeshtë dhe e kryer e vazhdueshme, nyjet.<br>Shkrim: Identifikimi i funksionit, njohja |

| | | |
|---|---|---|
| | Dëgjim: njoftimet në aeroport (përshtatja), Strategjitë e dëgjimit: përshtatja e informatave dhe dialogjeve, etj.<br>Lëxim: Problemet (ekstrakt i literatures së udhëtimit nga Bill Bryson), Frika nga fluturimi, Në lëvizje, etj.<br>Gramatikë: Koha e kryer e thjeshtë, Koha e kryer e thjeshtë e vazhduar.<br>Bisedë: diskutim rreth mjeteve të transportit, lojë në role, biseda rreth fotove, biseda rreth përvojave të udhëtimit nga studentët, etj. | me shkrimin dhe editimin e një raporti.<br>Gjuha e folur: Trajtat e shkurtëra.<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: myself, yourself, themselves, dhe each other/one another<br>Dëgjim: zgjidhje e shumëfishtë. |
| *Java e pestë:* | Moduli 4: Media:<br>Ngrohje, Fjalor (Media: TV, Revistat, Gazetat, Interneti, katastrofat, fjalët rreth mediave, foljet shumë-pjesëshe 4, etj.)<br>Dëgjim: Ekstrakte të programeve televizive, radio programe, një diskutim rreth TV-së, Strategjitë e dëgjimit: dëgjim për informata specifike, etj.<br>Lëxim: Çfarë ka në gazeta (Ekstraktet e gazetave), Strategjitë e leximit: marrja me referencat kulturore, Lajmet e fundit, Lajmet e internetit, etj.<br>Gramatikë: Diateza pësore (Transformimi i fjalive).<br>Bisedë: Tregimet e lajmeve, diskutime (temat për prezantim), bisedë rreth përdorimit të internetit dhe programeve të preferuara televizive dhe të radios. | Fjalor: Fjalet dhe shprehjet per media (TV programe, Internet, telefona mobil).<br>Gramatikë: Diateza pësore, mbiemrat.<br>Shkrim: Fjalët lidhëse kundërshtuese (in spite of, nevertheless)<br>Shqiptim: Shëndrrimi i y në i, shqyrtim i filmit<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: to have/get sth done.<br>Bisedë: përshkrimi i fotografisë |
| *Java e gjashtë:* | Moduli 5: Shpalljet (Reklamat)<br>Ngrohje, Fjalor (Shprehjet e shpalljeve 1 dhe 2, shprehjet idiomatike, llojet e shpalljeve të klasifikuara, foljet shumë-pjesëshe 5, problemet e blerjes)<br>Dëgjim: Shpallje të radios, dialogjet në dyqane (përshtatjet, etj.)<br>Lëxim: Shpalljet e rëvistave, trajtimi i shprehjeve idiomatike, shpalljet e klasifikuara, Kthimi prapa, etj.).<br>Gramatikë: Koha e ardhëshme e thjeshtë (Will, may/might, Koha e tashme e vazhduar, Koha e tashme e thjeshtë, be going to).<br>Bisedë: Boshllëqet e informacionit (pyetja për | Fjalor: Idiomat, mbiemrat e opinionit, shprehjet e shpalljeve.<br>Gramatikë: Koha e ardhëshme, përcaktuesit<br>Shkrim: fjalët lidhëse, shenjat e pikësimit (Pikëpyetjet), shkruarja e emailit.<br>Shqiptim: Tingujt individual - shkronjat e pazeshme.<br>Gjuha e folur: problemet e blerjes, ankesat.<br>Theksi dhe intonacioni: Nënvizimi.<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: nyjet |

| | | |
|---|---|---|
| | informacion dhe dhënia e informacionit), diskutimi i pyetësorit, lojë në role në dyqan, biseda rreth blerjeve të preferuara, etj. | |
| *Java e shtatë:* | Përmbledhje e njësive 1-5 dhe rishikim i gramatikës. Parapërgatitje për test. | Rishqyrtim i fjalorit dhe gramatikës Parapërgatitje për test |
| *Java e tetë:* | Kollokviumi 1. | Kollokviumi 1 |
| *Java e nëntë:* | Moduli 6: Njerëzit<br>Ngrohje, Fjalor (Dukja fizike, parafjalët për formimin e mbiemrave të kundërt, (ndërtimi i fjalëve), mbiemrat e personalitetit 1, foljet shumë-pjesëshe 6)<br>Dëgjim: Thirrjet televizive të policisë, Radio programe, intervista, Strategjitë e dëgjimit: pyetjet e vërteta/të pavërteta.<br>Lëxim: Gjeneratat (Ekstrakte të ditarit), lëximi në mes të rreshtave, Njerëzit duke shikuar, etj.<br>Gramatikë: Foljet modale për spekulime (transformimi i fjalive), mbiemrat personalitetit<br>Bisedë: Bisedë rreth fotografive, lojë në role, spekulimi rreth njerëzve bazuar në foto, përshkrimi i njerëzve, përshkrimi i shokëve apo anëtarëve të familjes. | Fjalor: Parafjalët për formimin e kuptimit të kundërt<br>Gramatikë: Foljet modale për spekulim, modalet për obligim, lejim dhe ndalim.<br>Shkrim: fjalët lidhëse; shqiptimi (shumës), përshkrim<br>Gjuha e folur: përshkrimi i njerëzve<br>Theksi dhe intonacioni: Te shfaqurit e interesit per dicka.<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: foljet modale në të kaluarën |
| *Java e dhjetë:* | Moduli 7: Mësimi<br>Ngrohje, Fjalor (Shqyrtimi i fjalëve kyçe nga moduli, foljet marr, kam, bëj, marr; fjalët e shkollës, foljet shumë-pjesëshe 7).<br>Dëgjim: Studentët flasin rreth mësimit, njerëzit flasin rreth shkollave të tyre të vjetra, dialogje.<br>Lëxim: Merrni mësim (artikujt e revistave, Strategjitë e lëximit: faktet dhe mendimet), Mësimdhënësit (artikujtë e revistave), etj.<br>Gramatikë: Fjalitë kushtore tre (transformimi i fjalive).<br>Bisedë: Përshkrimi dhe biseda rreth një fotografije, biseda rreth zgjidhjeve, loja kontradiktore, biseda rreth shkollës si dhe biseda e lirë rreth lëndëve të preferuara të shkollës dhe mësimit. | Fjalor: Strategjitë e mësimit të fjalorit; foljet get, have,make, take.<br>Gramatikë: fjalitë kushtore (zero, një, dy, tre).<br>Shkrim: Fjalët lidhëse (për dhe kundër); shenjat e pikësimit; eseu<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: foljet e pasuara nga forma –ing ose infinitivi |
| *Java e njëmbëdhjetë:* | Moduli 8: Karrierat | Fjalor: karrierat, mbiemrat e |

| | | |
|---|---|---|
| | Ngrohje, Fjalor (Mbiemrat e personalitetit 2, karrierat), bashkëvendosja, deleksikalizimi i foljeve do dhe make, Profesionet e rrezikshme, Gjetja e punës, etj.<br>Dëgjim: Dëgjimi i intervistës së punës, dokumentarit në radio, Strategjitë e Dëgjimit: marrja e shënimeve.<br>Lëxim: Punët e përkohshme (artikujt e revistave), Strategjitë e lëximit: kryetitujtë dhe paragrafet.<br>Gramatikë: Deklaratat e raportuara.<br>Bisedë: Bisedë rreth fotografive, loja e gjetjeve, lojë në role, bisedë rreth profesioneve të preferuara dhe planeve për të ardhmën. | personalitetit, emrat e përbërë; foljet do dhe make.<br>Gramatikë: deklaratat e raportuara, parafjalët e kohës, lëvizjes dhe vendit.<br>Shkrim: Fjalët lidhëse, (e në fund të fjalës); letra për aplikim<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: llojet e foljeve të raportuara |
| *Java e dymbëdhjetë:* | Moduli 9: Shoku Kulturor<br>Ngrohje, Fjalor (Ushqimi, vendet e famshme, sportet), konotacioni dhe përkthimi, foljet shumë-pjesëshe 9).<br>Dëgjim: Përshkrimi i stileve të jetës, programe në radio, dialogje (përshtatje).<br>Lëxim: Humbur në përkthim (Ekstrakte nga memuaret e Ewa Hoffman; pyetjet e vërteta/të pavërteta), Strategjitë e lëximit: trajtimi i fjalëve të vështira, Jeta jashtë vendit, Kujdes me sjelljet e juaja, të qënit i sjellshëm.<br>Gramatikë: Pyetjet e raportuara (transformimi i fjalive).<br>Bisedë: lojë e asocimit me fjalë, përshkrimi dhe biseda rreth fotografive, Strategji të të folurit: përgatitja për lojë në role, bashkëbisedim rreth stileve të jetesës dhe preferencat e studentëve. | Fjalor: Ushqimi, vendet e njohura, sporti, konotacionet dhe mbiemrat<br>Gramatikë: pyetjet e raportuara, question tags; urhdërat dhe kërkesat e raportuara<br>Shkrim: Fjalët lidhëse, shqiptimi (ligjërata e drejtë); letra joformale<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: fjalët lidhëse<br>Shkathtësi: bisedë – përshkrimi i fotografisë |
| *Java e trembëdhjetë:* | Moduli 10: Civilizimi<br>Ngrohje, Fjalor (Objektet e përditshme), mbiemrat (ndjenjat); foljet e lëvizjes, Civilizimi: foljet shumë-pjesëshe 10.<br>Dëgjim: Një program televiziv.<br>Lëxim: Qyteti i humbur (Ekstrakte të librit të udhëtimit), Strategjitë e lëximit; boshllëqet e fjalëve, I/E civilizuar?<br>Gramatikë: Wish/should have<br>Bisedë: Përshkrimi dhe biseda rreth një fotografije, boshllëku i | Fjalor: Datat dhe periudhat historike, mbiemrat (ndjenjat) foljet e lëvizjes<br>Gramatikë: Wish/Should have; fjalitë lidhëse<br>Shkrim: Fjalët lidhëse, shqiptimi (Anglishtja Britaneze dhe Amerikane); përshkrimi i një qyteti<br>Zgjidhja e problemeve gjuhësore: foljet me formën –ing dhe to + paskajore<br>Shkathtësi: bisedë – prezantimi i një teme |

| | | |
|---|---|---|
| | informacionit, diskutim, bashkëbisedim rreth civilizimeve të ndryshme. | |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | Punëtori të komunikimit Zgjidhje e problemeve gjuhësore, këndi i kulturës Shqiptim, tingujtë zanorë tek foljet e parregullta, fjalët e ndryshme që tingëllojnë njëjtë, theksi i fjalëve, gërmëzimi dhe tingujtë, | Diskutimi i një teme historike, kulturore, prezantimi i Eseut |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | Përmbledhje e njësive 6-10. Parapërgatitje për provimin përfundimtar. | Përmbledhje e njësive të mëparshme dhe përgatitje për provimin përfundimtar |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Në përgjithësi prezantimet e ligjëratave do të bëhen përmes MS PowerPoint, tabelës, përdorimit të materialeve, programeve kompjuterike dhe ushtrimeve numerike.
- Po ashtu, nga mësimdhënësit do të sigurohen edhe materiale tjera shtesë (punime shkencore, publikime, buletinet nacionale, si dhe zbulimet dhe hulumtimet e fundit).
- Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: organizata, kompani, njësitë prodhuese-përpunuese, etj.
- Gjatë çdo seancë do të organizohet qasja e bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentë!
- Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime!
- Do të vlerësohet kontributi i studentëve kur ata bashkëpunojnë dhe participojn në ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës!
- Ardhja e studentëve me kohë në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme!